

Sistemi shëndetësor

Sistemi shëndetësor në Zvicër është ndërtuar shumë mirë. Në mënyrë të gjithëpërfshirëse, të gjitha banoret dhe banorët janë detyrimisht të siguar nga aksidentet dhe sëmundjet. Një numër i madh ordinancash mjekësore, barnatoresh dhe spitalesh e sigurojnë shërbimin.

Sistemi i sigurimit

Në Zvicër, të gjitha banoret dhe banorët duhet të kenë një sigurim nga aksidentet dhe sëmundjet. Kush shpërngulet këtu, duhet t'i lidhë kontratat e sigurimeve në tre muajt e parë. Fëmijët duhet të sigurohen brenda tre muajve pas lindjes. Shërbimet e sigurimeve të detyrueshme janë të rregulluara me ligj. Të gjithë të siguarit kanë të drejtë për të njëjtin trajtim mjekësor.

Financimi

Sistemi shëndetësor zviceran financohet së bashku prej shtetit (konfederata, kantonet, komunitet, punëdhënësve dhe personave privatë. Personat privatë paguajnë një shumë mujore sigurimi për sigurimin e përkujdesjes gjatë sëmundjes dhe për sigurimin e aksidenteve. Shuma vendoset çdo vit dhe ndryshon sipas kantonit. Kush sëmuret apo ka një aksident, duhet të marrë gjithashtu pjesë në shpenzimet (shuma e përcaktuar dhe pjesëmarrja sipas përqindjes, Franchise und Selbstbehalt). Mirëpo këtu ka një shumë të përcaktuar maksimale në vit.

Përkthimet

Nuk është e lehtë, kur duhet të komunikoni në një gjuhë të huaj me mjeket, farmacistët apo infermierët. Prandaj disa spitale ofrojnë përkthime falas përmes interpretuesve ndërkulturorë të shkolluar posaçërisht. Pacientet dhe pacientët duhet të informohen vetë me kohë për këtë mundësi. Sado, interpretuesit mund të angazhohen gjithashtu për vizita mjekësore ose situata të tjera. Mirëpo atëherë duhet të paguhet vetë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/sistemi-shendetesor